



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 61, datë 31.07.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:

“GODINË BANIMI DHE SHËRBIMI ME 1, 3, 4, 7, 8 KATE MBI TOKË, ME 5 KATE PARKIM DHE SHËRBIME NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE PRANË LIQENIT TË THATË, KOPSHTI ZOOLOGJIK, SELITË, NJËSIA FARKË, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të Nenit 27 të Ligjit Nr. 66/2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”, Vendimt të Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 03.04.2024 “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave për pajisjen me leje zhvillimi, ndërtimi dhe certifikatë përdorimi për objektet e konfiskuara apo të transferuara në favor të shtetit me kontratë premtim shitjeje, me vlerë 1 euro”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Salillari” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi me 1, 3, 4, 7, 8 kate mbi tokë me 5 kate parkim dhe shërbime nëntokë”, me vendndodhje pranë Liqenit të Thatë, Kopshti Zoologjik, Selitë, Njësia Farkë, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Salillari” sh.p.k, konfiskuar me Vendimin Nr. 07, datë 09.11.2022 “Për konfiskimin për interes publik të objektit: “Godinë banimi dhe shërbimi 2, 4 dhe 6 kate, me 2-5 kate parkim dhe shërbime nëntokë”, me vendndodhje pranë Liqenit të Thatë (Kopshti Zoologjik), Selitë, Bashkia Tiranë, të ndërtuar në tejkallim të lejes së ndërtimit, dhe transferuar të drejtat me Kontratë kalim të të drejtave reale Nr. 6530 Rep., Nr. 3026 Kol., datë 31.08.2023.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Luftës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

ANËTAR/SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 22/09 2025